

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësi Dr.sc.Rafet Haxhaj kryetar, Nora Bllaca - Dula dhe Isa Shala, në çështjen juridike të paditësit Komuna e Vushtrrisë, kundër të paditurës NNT "[Ë...]" ne fshatin "[...]", Komuna Kaçanikut, për shkak të borxhit, e të vendosur sipas propozimit të paditurës për përsëritjen e procedurës, të përfunduar me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae.nr.192/2013 i datës 10.07.2015, e duke vendosur sipas ankesës së paditurës, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës EN.nr.30/2016 të datës 07.11.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 07.07.2017, mori këtë:

#### AKTVENDIM

REFUZOHET e pa bazuar ankesa e paditurës NNT "[Ë...]" ne fshatin "[...]", Komuna Kaçanikut, ndërsa aktvendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës EN.nr.30/2016 i datës 07.11.2016, VËRTETOHET.

#### Arsyetim

Me aktvendimin e atakuar të gjykatës së shkallës së dytë, refuzohet i pa bazuar propozimi i të paditurës NNT "[Ë...]", me të cilën ka kërkuara që të lejohet përsëritja e procedurës së përfunduar me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, e evidentuar si I.C.nr.609/2012 i datës 31.10.2013.

Kundër këtij aktvendimit, brenda afati ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet kërkesa për përsëritja e procedurës.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 dhe 240.4 të LPK-së, gjeti se:

#### Ankesa është e pa bazuar

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se me aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës EN.nr.30/2016 të datës 07.11.2016, është refuzuar si i pa bazuar propozimi i të paditurës NNT "[Ë...]", me të cilën ka kërkuara që të lejohet përsëritja e procedurës së përfunduar me aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, e evidentuar si I.C.nr.609/2012 i datës 31.10.2013. Ndërkaq, gjykatësi individual i Gjykatës së Apelit duke shqyrtuar propozimin për përsëritjen e procedurës në pajtim me dispozitat e nenit 232 par.1 pika a) dhe c), dhe nenin 233 pika 1 dhe 2 të LPK-së, ka gjetur se nuk janë plotësuar asnjëra nga kushtet e parapara ligjore për përsëritjen e procedurës. Konkludimin e kësaj gjykatësi individual e mbështet në dispozitën e nenit 239 dhe 240 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitivin e aktvendimit të atakuar.

Nisur nga një gjendje e tillë e çështjes, Gjykata e Apelit e Kosovës (kolegji) vlerëson se, thëniet ankimore të paditurës se aktvendimi i atakuar mbështet në vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, është i pa bazuar dhe i pa qëndrueshëm, për faktin se, gjykatësi individual i Gjykatës së Apelit duke shqyrtuar aktvendimin e atakuar dhe faktet e paraqitura nga e paditura, me të drejtë ka konkluduar se propozimi për përsëritje të procedurës në çështjen juridike të paditurës, lidhur me faktet e reja është i pa bazuar. Në këtë drejtim gjykatësi individual drejtë ka vepruar kur në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar ka gjetur mbështetje në dispozitën e nenit 232 pika g) të LPK-së, të cilin qëndrim e pranon edhe kolegji i Gjykatës së Apelit.

Me dispozitën e nenit 232 pika g) të LPK-së, në mënyrë decisive është përcaktuar se gjykata mund ta lejojë përsëritjen e procedurës sipas propozimit të palës *"Në qofte se pala merr dijeni për fakte të reja ose gjen prova të reja, ose e fiton mundësinë që t'i përdorë ato, në bazë të të cilave për palën do të mund të merrej vendim përfundimtar më i favorshëm, sikur faktet dhe provat e tilla të ishin përdorur në procedurën e mëparshme"*. Kolegji gjen se gjyqtari i vetëm me të drejtë ka konstatuar se arsyet e parashtruara në propozimin për përsëritjen e procedurës janë parashtruar në procedurë të shkallës së parë dhe janë vlerësuar me rastin e marrjes së aktgjykimit, përsëritja e të cilit kërkohet, dhe gjithashtu Gjykata e Apelit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, i ka marr për bazë dhe i ka shqyrtuar po të njëjtin propozim me rastin e marrjes së aktgjykimit, me të cilin është refuzuar ankesa si e pa bazuar dhe është vërtetuar aktgjykimi i shkallës së parë. Kolegji gjenë se nga procesverbali i gjykatës së shkallës së parë i mbajtur me 06.08.2013, në këtë seancë është miratuar propozimi i palës së paditur të nxjerrët ekspertiza e ndërtimtarisë për konstatimin dhe vlerësimin e të metave dhe defekteve në ndërtimin e rrugëve, sipas kërkesëpadisë, kurse, për eksperte është caktuar eksperti gjyqësor "[S.B]". Në të njëjtën seancë dhe në të njëjtin aktvendim është obliguar pala e paditur që brenda afatit prej 7 ditëve të deponoj shumën prej 500 € në arkën e gjykatës lidhur me kompensimin e ekspertit të caktuar. Gjykata e shkallës së parë me të njëjtin aktvendim ka paralajmëruar palën propozuese se nëse nuk kryhet pagesa e lartë cekur brenda afatit të dhënë nga gjykata e njëjta do të konsideroj se pala e paditur ka heqë dorë nga propozimi për ekspertizën. Më tutje nga procesverbali i datës 01.10.2013 del se, gjykata ka bërë konstatimin se pala e paditur e cila kishte bërë propozimin për nxjerrjen e ekspertizës nuk kishte bërë deponimin e mjeteve siç edhe ka qenë e obliguar me aktvendim. Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e datës 01.10.2013 ka konsideruar se i padituri ka hequr dorë nga propozimi për marrjen e provës, në nxjerrjen e ekspertizës së ndërtimtarisë duke u mbështetur në dispozitat e nenit 451 pika 3 të LPK-së.

Nga kjo rezulton se rrethanat dhe faktet e paraqitura me propozimin për përsëritje të procedurës nuk përbejnë shkak që të lejohet përsëritja e procedurës. Për këto shkaqe, kolegji ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë të pa bazuara dhe aktvendimi i nxjerre nga gjyqtari individual i kësaj gjykate, të vërtetohet.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 par.1, lidhur me nenin 240 par.4 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Ae.nr.1/2017, me datë.07.07.2017.

GJYKATËSI  
Dr.sc. Rafet Haxhaj

